



UN-HABITAT

**Programi i Mbështetjes
së Planifikimit Hapësinor
Komunal në Kosovë**



PISG

**Ministria e Mjedisit dhe
Planifikimit Hapësinor**



**Organizata për Siguri
dhe Bashkëpunim në
Evropë**

Për jetë më të mirë në komunën tonë

12 dhjetor 2006

Ky dokument u prodhua në bazë të kontributit të UN-HABITAT-it, Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe Misionit të OSBE-së në Kosovë, mbi “Punëtorinë e Avancimit dhe Rregullimit Urban të Vendbanimeve Joformale në Kosovë” të mbajtur në Hotelin Grand, Prishtinë, më 16 nëntor 2006, si mënyrë për të ecur përpara në parandalimin, rregullimin dhe avancimin urban të vendbanimeve joformale në komunat e Kosovës.

Gjatë dekadave të kaluara, e sidomos pas luftës, shumë lagje janë zhvilluar në dhe rreth qyteteve në gjithë Kosovën. Pasi që këto lagje janë ndërtuar pa plane urbane dhe leje ndërtimi, e nganjëherë edhe në tokë të huaj, ato përshkruhen tani si “vendbanime joformale”. Ekzistojnë lloje të ndryshme të vendbanimeve joformale në Kosovë. Në shumicën e rasteve, këto vendbanime ndërtohen nga vetë pronarët e tokave. Në raste tjera, banorët nuk kanë tituj të regjistruar të pronës. Disa nga këto lagje mund të jenë të pasura, përndryshe, kushtet e jetesës mund të jenë edhe skajshmërisht të varfra. Kjo ndodh më së shumti në “mëhallët” rome, ashkali e egjiptiane të Kosovës.

Derisa këto lagje zakonisht shfaqin shenja të rritjes ekonomike, zhvillimi i tyre i pakontrolluar ka pasoja negative në ekonominë e qyteteve, pasi që komunat duhet të paguajnë gjitha shpenzimet e sigurimit të infrastrukturës. Investitorët privatë dhe banorët gjithashtu duhet të kontribuojnë në përmirësimin e kushteve. Secili në Kosovë ka “të drejtën në qytet”; të drejtën e qasjes ndaj infrastrukturës publike, shërbimeve dhe stabilimenteve, si dhe të kontribuojë në procesin e zhvillimit. Megjithatë, secili ka përgjegjësi në realizimin e kësaj, si pagimin e tatimeve e faturave, si dhe respektimin e të drejtave pronësore të tjetrit, e edhe rregulloreve ndërtimore e urbane.

Më 16 nëntor 2006, MMPH-ja, UN-HABITAT-i dhe Misioni i OSBE-së në Kosovë organizoi një punëtori në të cilën gjitha komunat, ministrinë gjegjëse si dhe shoqëria civile e sektori privat, shqyrtuan këtë gjendje bashkë me ekspertë të njohur botërorë.

Si rezultat, organizatorët kanë përgatitur listën e rekomandimeve në vijim për institucionet kosovare dhe vetë banorët e vendbanimeve joformale:

Caqet e përgjithshme:

- I. Parandalimi i zhvillimit të ardhshëm të vendbanimeve joformale, si dhe rregullimi e avancimi, sipas mundësisë, i atyre ekzistuese;
- II. Sigurimi i një procesi të qëndrueshëm të urbanizimit në Kosovë; si dhe
- III. Ndërtimi i një politike të qëndrueshme të planifikimit hapësinor, tokës dhe banimit në Kosovë, përmes zbatimit të: a) kornizës së duhur ligjore; b) bashkëpunimit të përforcuar institucional; c) kapacitete më të mira teknike, si dhe d) përfshirja e sektorit privat dhe banorëve të vendbanimeve joformale.

Rekomandimet:

A. Për Qeverinë e Kosovës

1. Zbatim i vazhdueshëm i Deklaratës së Vjenës përmes Kornizës Kosovare. “Deklarata e Vjenës për Vendbanimet Joformale” e vitit 2004, një deklaratë ndër-qeveritare e promovuar nga Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore, përfshin një grup të parimeve të përbashkëta regjionale për parandalim dhe rregullim. Deklarata e Vjenës e zbaton një proces të rëndësishëm për përforcimin e kapaciteteve dhe ndarjen e eksperiencës përmes takime regjionale shqyrtuese. Në këtë aspekt, rekomandohet që të njihen sfidat dhe mundësitë e ngritura nga zhvillimi joformal i tokës, përmes zbatimit të vazhdueshëm të Deklaratës së Vjenës mbi Vendbanimet Joformale, në kornizë kosovare.
2. Plani i Veprimit Kosovar për Vendbanimet Joformale. Në linjë me Planin e Veprimit për Partneritetin Evropian, të formulohet një plan detaj veprimi për parandalimin e vendbanimeve të ardhshme joformale, si dhe rregullimin e avancimin urban të atyre ekzistuese, duke marrë parasysh llojet e ndryshme të vendbanimeve që ekzistojnë në Kosovë (lagje të varfra, të pasura, zotërim i pasigurt i pronës, prezenca e elementeve të qëndrueshmërisë, etj.) për t’i trajtuar ato në mënyrën e përshtatshme. Kjo do të mundësojë, *inter alia*, financimin e infrastrukturës dhe projektet e zhvillimit të bashkësisë me donatorët ndërkombëtarë. Prioritet i duhet dhënë lagjeve rome, ashkali dhe egjiptiane, si grupet më të ndjeshme. Duhet definuar konceptet, qëllimet, caqet, veprimet dhe partneritetet që duhen arritur në afatin e mesëm dhe të gjatë.
3. Faqja e internetit për vendbanimet joformale. Si pjesë e aktiviteteve të vazhdueshme të ngritjes së vetëdijes, të krijohet një faqe interneti për vendbanimet joformale, me lidhëse ndaj burimeve ekzistuese mbi parandalimin dhe rregullimin e vendbanimeve joformale (MMPH). Kjo do të krijojë një rrjet virtual mësimi mbi vendbanimet joformale për qeverinë,

shoqërinë civile, sektorin privat, përfaqësuesit e lagjeve, si dhe anëtarët e universitetit.

4. Reforma ligjore. Të vazhdohet shqyrtimi i ligjeve mbi shfrytëzimin e tokës, planifikimin hapësinor, banimin dhe ndërtimin për të siguruar parandalimin, rregullimin dhe avancimin urban të vendbanimeve joformale. Në veçanti, a) të merren parasysh dispozitat specifike mbi nën-ndarjen (parcelizimin) e tokës brenda prapavijës së shqyrtimit të Ligjit mbi Planifikimin Hapësinor për të siguruar kontributin e ndërtuesve ndaj interesit publik, si dhe b) të merret parasysh zgjerimi i fushëveprimit të “Projekt Ligjit mbi Tokën Ndërtimore”, ashtu që të përmbajë dispozitat që mundësojnë rregullimin e vendbanimeve joformale; si dhe c) të vlerësohen mundësitë e thjeshtimit dhe standardizimit të procedurave ekzistuese për sigurimin e lejeve të ndërtimit.
5. Ndërtimi i kapaciteteve. Të sigurohet pjesëmarrja e zyrtarëve gjegjës të MMPH-së dhe komunave në programet rajonale të ndërtimit të kapaciteteve. Të zhvillohen propozimet për të siguruar që ekspertiza rajonale e ndërkombëtare të ofrohet brenda këtyre trajnimeve.
6. Sistemet e tatimit. Të vlerësohen mundësitë e rishqyrtimit të sistemit të tatimit pronësor dhe të sigurohen burimet financiare për programet e rregullimit, anash donatorëve ndërkombëtarë. Në këtë kuptim, Komunitat duhet të integrojnë ndërtimet e reja në sistemin tatimor.

B. Për Komunitat

1. Integrimi urban dhe hapësinor. Të zhvillohet një vizion mbi vendbanimet joformale, përmes formulimit të Planeve Zhvillimore Komunitare e Urbane.
2. Profilat Komunitare të Vendbanimeve Joformale. Të krijohen grupe detyrash të cilat angazhojnë shoqërinë civile dhe përfaqësuesit e komuniteteve, si dhe të themelohen profilet e vendbanimeve joformale brenda komunave.
3. Programet e banimit. Të elaborohet një vlerësim nevojash, si dhe të hartohen strategjitë lokale mbi banimin e arritshëm (të lirë).
4. parandalimi i ndërtimeve ilegale dhe vendbanimeve të reja joformale. Në bashkërendim me MMPH-në, të merren masa kundër ndërtimeve ilegale.
5. Prona publike, shtetërore dhe shoqërore. Në rastet kur vendbanimet joformale kanë zënë pronen publike, shtetërore apo shoqërore, të vlerësohen, në bashkëpunim me qeverinë dhe aktorët ndërkombëtarë, mundësitë e rregullimit, në bazë të nevojave, prioritetëve, krahasimit të interesave publike e private, si dhe ligji.
6. Mbrojtja e pakicave. Të përmirësohen kushtet në zonat më të skajshme, duke përfshirë lagjet e romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve.
7. Zhvillimi i projekteve me bazë në komunitet. Të përcaktohen prioritetet, të zhvillohen e zbatohen projektet e vendbanimeve joformale përmes metodave

të pjesëmarrjes së komunitetit. Përkushtimi i vetë banorëve duhet të jetë parakusht.

8. Partneritetet publiko-private. Të arrihen marrëveshje me ndërtuesit privatë të tokës për të siguruar që qytetet të përfitojnë nga veprimtaria e tyre.

C. Për vetë banorët e vendbanimeve njerëzore

1. Angazhimi publik i banorëve të lagjeve. Banorët e vendbanimeve joformale duhet të marrin pjesë në procesin e planifikimit si dhe të kenë rol aktiv në përmirësimin e lagjeve të tyre.
2. Përgjegjësitë e banorëve. Banorët duhet të paguajnë tatimet e tarifave e nevojshme për sigurimin e shërbimeve si rrugët, uji, rryma elektrike dhe kanalizimi.
3. Banorët të respektojnë të drejtat pronësore dhe ligjet mbi planifikimin hapësinor e ndërtimit. Banorët duhet të sigurojnë lejet e duhura para ndërtimit. Uzurpimi ilegal nuk është zgjidhje: banorët gjithmonë duhet të respektojnë tokën dhe pronën e personave tjerë, si dhe pronën publike.